



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 02.02.2026

V E N D I M

Nr.4, datë 2.02.2026

PËR

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT RREGULLORE “PËR
PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRLLOGARITJEN E MASËS
ADMINISTRATIVE ME GJOBË**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 02 shkurt 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Projektregullore “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”.

BAZË LIGJORE:

1. Pika 3 e nenit 183 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për miratim për këshillim publik të dokumentit projektregullore “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”.
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i projektvendimit;

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri nr. 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar, Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (EECC).
2. Dokumenti për këshillim publik: Projektregullore “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”, është hartuar në përputhje me përcaktimet e reja të pikës 3 të nenit 183 të ligjit nr. 54/2024 dhe ligjit nr. 99, datë 12.09.2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: *“AKEP-i përcakton me vendim parimet, kriteret dhe metodologjinë e përllogaritjes së masës së gjobave, si dhe procedurën e veprimtarisë inspektuese në zbatim të këtij ligji dhe ligjit procedural kombëtar”*.
3. Neni 184 i ligjit nr. 54/2024, nuk parashikon masa fikse të sanksioneve me gjobë, por përcakton kufijtë maksimal të tyre duke marrë si referencë të ardhurat vjetore bruto, të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike, për vitin kalendarik paraardhës. Në këtë kontekst, është e nevojshme hartimi i një metodologjie që përcakton masat e gjobave me qëllim evitimin e vendosjes arbitrare të tyre në përfundim të veprimtarisë inspektuese.
4. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe rregullores “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi, do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit: Projektregullore “Për përcaktimin e metodologjisë për përlogaritjen e masës administrative me gjobë”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3, të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik projektregullore “Për përcaktimin e metodologjisë për përlogaritjen e masës administrative me gjobë”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave, Kontrollit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka